

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

Seanca Plenare  
Seanca nr.2003/23  
Prishtinë,më 11 shtator 2003,në orën 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit të Prishtinës.

**PROCESVERBAL**

Seancën e kryesoi Nexhat **DACI**, kryetar i Kuvendit, kurse bashkëkryesues ishte Oliver Ivanoviq,anëtar i Kryesisë.

**Kryesusi** konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 109 deputetë dhe shpalli të hapur punën e saj.

Kuvendi në seancën e mëparshme kishte miratuar këtë

**REND TË DITËS**

1. Paraqitja para deputetëve e z.Hari Holker,PSSP dhe z.Kris Paten,komesioner i BE-së;
2. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme;
3. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për prokurimin publik në Kosovë-nr.2003/13;
4. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për pension të aftësis së kufizuar-2003/23;
5. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Çështje Gjyqësore,Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese për emërimin e dy gjyqëtarëve në bazë të të dhënave shtesë;
6. Shqyrtimi i propozimit të Grupit Parlamentar të LDK-së për emërimin e disa anëtarëve në komisionet parlamentare;dhe
7. Propozimi i rendit të ditës të seancës plenare të 18 shtatorit 2003.

Kryetari i përshëndeti z.Holkeri, z.Paten, Qeverinë dhe përfaqësuesit e zyrave të shteteve perendimore në Prishtinë. Ai i informoi të pranishmit me punën e Kuvendit, në të kaluarën dhe me sfidat me të cilat tani po ballafaqohet.

1. Kryetari kërkoi nga deputetët e Kuvendit të procedohet sipas rendit të ditës dhe e ftoi z.Hari Holker të flasë para tyre.

**Hari Holkeri** -Dëshiroj t'ju shprehim falënderimin tim që më dhatë mundësinë t'i drejtohem këtij Kuvendi.

Sot shënojmë përvjetorin e dytë të sulmeve terroriste në Nju Jork dhe në Uashington. Vrasja e qytetarëve të pafajshëm nga e mbarë bota, ishte një sulm, të cilin terroristët po e bënin mbi civilizimin, sepse i tërë civilizimi ushqen rrespektin për dinjitetin e qenieve individuale njerëzore dhe janë vlera këto mbi të cilat edhe Organizata e Kombeve të Bashkuara, është themeluar.

Zonja dhe zotërinj, unë tashmë jam konsultuar me liderët politik kosovar dhe po ashtu e mirëpres punën të cilën do ta bëjmë bashkërisht gjatë javëve dhe muajve të ardhshëm. Bashkëpunimi ynë efikas është domethënës për vazhdimin e përparimeve në Kosovë. Por, as UNMIK-u, as institucionet e Kosovës nuk mund të përfitojnë në kurriz të tjetrit. Realiteti është i atillë që ne jemi partnerë, në kuptimin më të gjërë dhe në këtë vetëm nëse punojmë bashkërisht do t'ia dalim të gjithave me sukses, sepse ne do të jemi partnerë. Kurse, tani kam kënaqësinë që t'i shpreh mirëseardhje në Kosovë në mënyrë tjetër të Kosovës, zotit Kris Paten, që është komisioneri i Bashkimit Evropian për politikë të jashtme. Që nga viti 1999 Bashkimi Evropian ka kontribuar dhe ka dhënë më shumë se një miliard euro ndihmë për Kosovën dhe Shtylla e katërtë e UNMIK-ut, Ai ka marrë rolin udhëheqës për të transformuar ekonominë e Kosovës. Bashkimi Evropian, po ashtu, ka krijuar një mekanizëm të posaçëm përcjellës për standardet, i ashtuquajtur STM që do të përcjellë përmbushjen e standardeve të Kosovës, të cilët do të ndihmojnë në përcaktimin e statusit përfundimtar të Kosovës. Ndihma financiare si dhe vetë ky mekanizëm përcjellës, paraqesin vendosmërinë e Bashkimit Evropian për t'i ndihmuar Kosovës që të bëhet anëtar i plotë i familjes së Bashkimit Evropian. Kriteret evropiane për anëtarësim, përfshijnë institucionet demokratike, rendin, ligjin dhe ekonominë të bazuar në tregun e lirë. Prandaj, Qeveria dhe Kuvendi, gjatë miratimit të 27 ligjeve, mund të them se ka qenë në arritur e madhe për të krijuar një ambient të mirëfilltë. Qeveria, pothuaj, ka kompetenca në sfera të ndryshme të jetës së përditshme në Kosovë. Sa i përket fushës së drejtësisë ose zbatimit të ligjit, policët e SHPK, punojnë bashkërisht me ata të UNMIK-ut. Po ashtu janë më shumë se 100 gjyqtarë e prokurorë që punojnë në sistemin e drejtësisë, që do të thotë se autoriteti përfundimtar për çështje të sigurisë dhe drejtësisë më janë besuar mua, por shumë prej aspekteve administrative të drejtësisë tashmë janë bartur tek institucionet kosovare. Pra, marrja e pronësisë nga institucionet kosovare dhe popullata, mbi këto aspekte, janë me rëndësi në përpjekjet për të përmirësuar gjendjen e sigurisë. Sa i përket ekonomisë, tashmë ka filluar procesi i privatizimit me më shumë se 20 ndërmarrje në pronësi shoqërore, të cilat janë kryer procedurat e tenderit.